



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 88 Akti

Nr. 94 Vendimi
Tiranë, më 21.12.2018

V E N D I M

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, me anë të trupit gjykues të përbërë nga:

Firdes Shuli
Roland Ilia
Etleda Çiftja

Kryesuese
Anëtar
Relatore

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Olsida Goxhaj, në prezencë edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, znj. Marie Tuma, më datë 19 dhjetor 2018, ora 11:30, në Pallatin e Koncerteve, kati i I-rë, Tiranë , zhvilloi seancën dëgjimore mbi çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Agron Vavla, gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat.**

OBJEKTI: **Rivlerësimit kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe neni Ç, D dhe Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;**
Ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;
Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;
Ligji nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoji arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, znj. Etleda Çiftja, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht, dëgjoji subjektin e rivlerësimit, z. Agron Vavla, vëzhguesin ndërkombëtar, znj. Marie Tuma, pasi shqyrtoi në tërësinë e saj çështjen që i përket subjektit të rivlerësimit, z. Agron Vavla, i cili në seancë dëgjimore publike kërkoi konfirmimin e tij në detyrë, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT PROCEDURALE

1. Z. Agron Vavla është subjekt i rivlerësimit për shkak të funksionit të tij si gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat. Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë të ligjit nr. 76/2016, datë 22.07.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar” dhe ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (këtu e më poshtë referuar si “ligji nr. 84/2016”), specifikon se: *“Të gjithë gjyqtarët, duke përfshirë gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë; të gjithë prokurorët, duke përfshirë Prokurorin e Përgjithshëm, Kryeinspektorin dhe inspektorët e tjerë pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë, i nënshtrohen rivlerësimit ex officio”.*

2. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (KPK) është institucioni që kryen procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, bazuar në nenin 179/6, paragrafi 5 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në nenin 3, pika 5 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

3. Z. Agron Vavla është shortuar në 15 janar 2018, me trupin gjykues nr. 4, të përbërë nga:

Roland Ilia Komisioner

Firdes Shuli Komisionere

Etleda Çiftja Relatore

4. Menjëherë me hedhjen e shortit, u administruan raportet e vlerësimit të hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (këtu e më poshtë referuar si “**ILDKPKI**”), sipas neneve 31 - 33 të ligjit nr. 84/2016; Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (këtu e më poshtë referuar si “**DSIK**”), sipas ligjit 34 - 39 të ligjit nr. 84/2016 dhe Këshilli i Lartë i Drejtësisë (këtu e më poshtë referuar si “**KLD**”), sipas neneve 40 - 44 të ligjit nr. 84/2016.

5. Trupi gjykues i shortuar, më datë 15.01.2018, pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (këtu e më poshtë referuar si “**Komisioni**”), me vendimin nr. 1, më datë 24.01.2018, pas studimit të raporteve të sipërpërmendura të vlerësimit, të hartuara nga institucionet shtetërore, vendosi të fillojë hetimin administrativ të thellë dhe të gjithanshëm sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit; të caktojë kryesuese të trupës, znj. Firdes Shuli; të gjithë anëtarët deklaruan mosqenien në kushtet e konfliktit të interesit.

6. Më datë 05.12.2018, trupi gjykues, me anë të vendimit nr. 02 vendosi: (i) të përfundojë hetimin paraprak për subjektin e rivlerësimit, z. Agron Vavla, bazuar në relatimin mbi

rezultatet e hetimit të paraqitur nga relatori i çështjes; (ii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit se i ka kaluar barra e provës mbi rezultatet e hetimit, në bazë të Aneksit të Kushtetutës në lidhje me nenin 52 të ligjit nr. 84/2016; (iii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit për t'u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016, neneve 45 - 47 dhe 35 - 40 të Kodit të Procedurave Administrative; (iv) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi të drejtat që gëzon nga ligji në lidhje me deklarimin e konfliktit të interesit, të drejtën për të kërkuar marrjen e provave të tjera ose thirrjen e dëshmitarit, si edhe afatin brenda të cilit mund t'i ushtrojë këto të drejta.

7. Më datë 05.12.2018, me anë të postës elektronike, trupi gjykues, njoftoi subjektin e rivlerësimit mbi: (i) rezultatet e hetimit kryesisht; (ii) kalimin e barrës së provës sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe që të sjellë prova për të provuar të kundërtën, nëse disponon, brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit me *e-mail*; (iii) njohjen me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016, neneve 45 - 47 dhe 35 - 40 të Kodit të Procedurave Administrative, duke paraqitur kërkesë për njohje me dosjen brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit me *e-mail*; (iv) përbërjen e trupës gjykuese.

8. Më datë 17.12.2018, me anë të vendimit nr. 3, trupi gjykues vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit, z. Agron Vavla, në seancë dëgjimore në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016 dhe, me anë të postës elektronike subjekti i rivlerësimit u njoftua se seanca dëgjimore do të zhvillohej, më datë 19.12.2018, ora 11:30, në Pallatin e Koncerteve, kati i I-rë, Tiranë.

9. Më datë 19.12.2018, ora 11:30, u zhvillua seanca dëgjimore me prezencën e subjektit të rivlerësimit.

10. Më datë 14.12.2018, subjekti i rivlerësimit solli shpjegimet përfundimtare. Në të njëjtën kohë, ai kërkoi të mos merret parasysh raporti i dorëzuar nga ana e ILDKPKI-së, pasi ai ka qenë drejtues i njësisë së posaçme të hetimit të korrupsionit dhe pasurisë pranë Prokurorisë së Krimeve të Rënda. Komisioni nuk e pranoi këtë kërkesë, për shkak se subjekti i rivlerësimit nuk solli prova për të vërtetuar pretendimin e tij sipas parashikimeve të ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005, "Mbi parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike".

11. Komisioni vendosi të përfundojë procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, z. Agron Vavla, vetëm mbi komponentin e vlerësimit të pasurisë, pa përfshirë në vendim kriterin e vlerësimit të figurës dhe atë të vlerësimit profesional.

12. Në lidhje me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se mbyllja e hetimit kryesisht vetë mbi kriterin e pasurisë e vendos Komisionin në pozita tërësisht paragjykuese për këtë proces dhe vendimmarrje.

Në analizë të këtij pretendimi, Komisioni çmon se dispozita që legjitimon dhe normon këtë vendimmarrje, është neni 4, pika 2, e ligjit nr. 84/2016, e cila parashikon se: "*Komisioni dhe Kolegji i Apelimit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit. Vendimi merret bazuar në një ose disa prej kritereve, në vlerësimin e përgjithshëm të tri kritereve ose në vlerësimin tërësor të procedurave.*"

Në kuptim të kësaj dispozite, vendimi për procesin e rivlerësimit për subjektet e rivlerësimit mund të merret bazuar në një ose disa prej kritereve, që do të thotë se nëse në një moment të caktuar të zhvillimit të procedurës hetimor administrativ, Komisioni arrin në përfundimin se ekzistojnë shkaqe për shkarkimin e subjektit të rivlerësimit bazuar në rezultatet e arritura nga procedura hetimore për vlerësimin edhe vetëm të një kriteri, ligji e lejon që Komisionin të mbyllë procedurën e rivlerësimit për atë kriter dhe të marrë një vendim për shkarkimin e subjektit, pa qenë e nevojshme që procedura administrative të vazhdojë më tej me verifikimin e kritereve të tjera, për sa kohë një vendim është bërë tashmë i arritshëm.

13. Për shmangien e çdo keqinterpretimi, ky vendim mbi përfundimin e procesit të rivlerësimit për, z. Agron Vavla, merret vetëm mbi kriterin e vlerësimit të pasurisë dhe kjo nuk përbën gjë të gjykuar (*res judicata*) për kriterin e vlerësimit të figurës dhe atë të vlerësimit profesional.

II. SEANCA DËGJIMORE

Më datë 19.12.2018, u zhvillua seanca dëgjimore, në prezencë të subjektit të rivlerësimit, në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016 dhe në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, znj. Marie Tuma.

Në seancë subjekti i rivlerësimit u paraqit personalisht dhe parashtroi shpjegimet e tij në seancë, si dhe i depozitoi ato me shkrim pranë Komisionit.

Seanca dëgjimore e datës 19.12.2018 u ndërpre, për të rifilluar më datë 21.12.2018, për shpalljen e vendimit. Subjekti i rivlerësimit ishte prezent dhe depozitoi shpjegimet e tij me shkrim pranë Komisionit.

Në përfundim të seancës dëgjimore, subjekti i rivlerësimit kërkoi konfirmimin në detyrë.

III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

14. Subjekti i rivlerësimit, z. Agron Vavla, ka qenë bashkëpunuese në procesin e rivlerësimit të saj, duke u përgjigjur kur është kërkuar, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI ADMINISTRATIV I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Procesi i rivlerësimit që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b dhe Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Megjithëse sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me vlerësimin pasuror, referuar vendimit nr. 2/2017¹ të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

¹ 41.Për rrjedhojë, gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas nenit 179/b, pika 5, të Kushtetutës, rivlerësimi kryhet nga Komisioni, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit nr. 84/2016: “Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryhen vetë Komisioni gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit nr. 84/2016, parashikohet se: “Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelit, Komisionerët Publikë, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë”. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se: “Në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse.”

V. RIVLERËSIMI I PASURISË

V/1. Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja

15. Me shkresën nr. ***, datë 12.02.2018, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar, pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, z. Agron Vavla , i cili është bërë subjekt deklarues pranë ILDKPKI-së në vitin 2003, me numër indeksi *** dhe në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 9367, datë 10.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar.

16. Subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar deklaratat e interesave private nga viti 2003 deri në vitin 2016 dhe, referuar ligjit nr. 84/2016, ka dorëzuar “Deklaratën e Pasurisë së Rivlerësimit Kalimtar, Vetting”, më datë 30.01.2017. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera nga ILDKPKI-ja për secilën pasuri dhe të ardhur të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit dhe personave të lidhur, është konstatuar:

- *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin*
- *nuk ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

V/2. Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni

17. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, hetoi dhe vlerësoi të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga vetë subjekti pranë ILDKPKI-së në “Deklaratën e Pasurisë për Rivlerësimin Kalimtar, Vetting” të vitit 2017; (b) raportin e dorëzuar pranë Komisionit nga ILDKPKI-ja; (c) deklaratat e interesave private, periodike vjetore pranë ILDKPKI-së nga viti 2003 deri 2016 (d) provat shkresore/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (e) deklarinimet e subjektit të rivlerësimit me anë të komunikimit elektronik; (ç) shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit, datë 19.11.2018, e në vijim, deri ditën e seancës dëgjimore për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

18. Komisioni hetoi në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të ILDKPKI-së, ashtu sikurse të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me ligjin nr. 84/2016, hetim i cili konsistoi në (i) verifikimin e vërtetësisë së deklarinimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe personave të lidhur; (ii) në verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve, me qëllim evidentimin e mungesës së mundshme të burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; (iii) në evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi ose përdorim; dhe (iv) në evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklarinimeve të rreme apo të ndonjë konfliktit të interesave, të parashikuar nga neni 33, pika 5, e ligjit nr. 84/2016.

19. Mbi dorëzimin e deklaratës së pasurisë sipas ligjit nr. 84/2016, nga verifikimi i datës së dorëzimit të deklaratës së pasurisë “Vetting” në zbatim të nenit 31/1², rezulton se subjekti i rivlerësimit, z. Agron Vavla, e ka dorëzuar deklaratën e pasurisë (duke përfshirë personat e lidhur) në bazë të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, më datë **24.01.2017**, dhe ky fakt konfirmohet nga ILDKPKI-ja nëpërmjet vërtetimit të lëshuar. Për sa më sipër, subjekti e ka dorëzuar deklaratën e pasurisë në periudhën kur ligji ka qenë në fuqi dhe brenda afatit 30 ditor nga hyrja e tij në fuqi.

V/3. Në lidhje me pasuritë dhe likuiditetet e deklaruara në “Deklaratën e Pasurisë për Rivlerësimin Kalimtar, Vetting” të vitit 2017, nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur:

Deklarimet e subjektit të rivlerësimit.

1. Apartament banimi, me sipërfaqe totale 57.1 m², ndodhur në, lagja “**”, Berat.**

a. Komisioni, për vërtetimin e faktit dhe burimit të të ardhurave, administroi:

1.1 Deklaratën “Vetting” të vitit 2017 dhe dokumentacionin bashkëlidhur, dorëzuar pranë ILDKPKI-së, më datë 24.01.2017.

1.2 Deklaratën e interesave private për herë të parë, të vitit 2003.

1.3 Certifikatë pronësie, datë 25.11.2002, për apartament me sipërfaqe 57.1 m², ndodhur në Berat, në pronësi të Agron dhe F.V.

1.4 ZVRPP-ja Berat, me shkresën nr. *** prot., datë 05.02.2018, konfirmon se z. Agron Vavla dhe znj. F.V. kanë në pronësi një apartament me sip. 57.1 m², përfituar nga Enti Kombëtar i Banesave, me kontratë shitje nr. ***, datë 09.01.2002, me vlerë 404.777 lekë. B/lidhur shkresës kartela e pasurisë së apartamentit me sip. 57.1 m² dhe kontrata e shitblerjes me Entit Kombëtar të Banesave.

1.5 Në kontratën e shitblerjes me Entin Kombëtar të Banesave, vlera e kësaj pasurie është **325.256 lekë**, nga praktika e ardhur pranë Komisionit nga ZVRPP-ja Berat.

b. Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me ligjin e zbatueshëm.

1.6 Në deklaratën “Vetting” të vitit 2017, subjekti deklaroi se ka në pronësi një apartament, me nr. pasurie ***, vol. ***, fq. ***, ZK ***, me sipërfaqe totale 57.1 m², lagja “****”, Berat, blerë nga Enti Kombëtar i Banesave, në vlerën 404.777 lekë, sipas kontratës noteriale me nr. ***, datë 09.01.2002

1.7 Burimi i krijimit sipas deklaratës “Vetting” janë të ardhurat familjare. Pjesa takuese: 50 %

1.8 **Nga hetimi administrativ kryesisht u konstatua se** në lidhje me çmimin e blerjes së këtij apartamenti, ka mospërputhje midis deklaramit në deklaratën “Vetting” të vitit 2017, deklarimit për herë të parë në vitin 2003 dhe kontratës së shitblerjes nga Enti Kombëtar i Banesave (për më shumë referohu fakteve më lart).

1.9 Në deklaratën e interesave private për herë të parë në vitin 2003, subjekti ka deklaruar: Apartament banimi, me nr. pasurie ***, vol. ***, fq. ***, lagja “****”, Berat, blerë nga Enti

²Subjekti i rivlerësimit ka detyrimin të plotësojë deklaratën e pasurisë, sipas shtojcës 2 të ligjit, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi dhe e dërgon atë pranë ILDKPKI-së.

Kombëtar i Banesave me këste në vlerën prej 700.000 lekësh. Ndërkohë që në deklaratën “Vetting”, më datë 30.01.2017, e ka deklaruar vlerën e kësaj pasurie në shumën 404.777 lekë dhe në kontratën e shitblerjes me Entin Kombëtar të Banesave vlera e kësaj pasurie është 325.256 lekë, nga praktika e ardhur pranë Komisionit nga ZVRPP-ja Berat.

1.10 Komisioni, pasi shqyrtoi dhe analizoi shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit arrin në përfundimin se:

1.10.1 Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur në mënyrë të pasaktë dhe jo në përputhje me ligjin çmimin e blerjes së këtij apartamenti në deklarimin e interesave privatë për herë të parë në vitin 2003.

1.10.2 Neni 4, i ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, parashikon se: *“Subjektet ...detyrohen të deklarojnë në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave brenda datës 31 mars të çdo viti, gjendjen deri më 31 dhjetor të vitit paraardhës të interesave private, brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë, burimet e krijimit të tyre, si dhe të detyrimeve financiare...”*

1.10.3 **Në lidhje me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se:** *“ unë kam pasqyruar vlerën e tregut të shitjes në momentin e deklarimit dhe jo vlerën e pasqyruar në kontratën e shitjes”*

Komisioni arsyeton se pretendimi i subjektit nuk qëndron pasi ligji për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe disa punonjësve publikë, është i qartë dhe se çdo deklaram bazohet në dokumentacionin ligjor justifikues. Në këtë rast, subjekti nuk është bazuar në dokumentacion ligjor justifikues.

2. Apartament banimi, me sipërfaqe 110.80 m² dhe garazhin me sipërfaqe 17 m², ndodhur në, Rr. “*”, Tiranë.**

a. Komisioni, për vërtetimin e faktit dhe burimit të të ardhurave, administroi:

2.1 Deklaratën “Vetting” të vitit 2017 dhe dokumentacionin bashkëlidhur, dorëzuar pranë ILDKPKI-së.

2.2 Deklaratën e interesave privatë periodike vjetore të vitit 2015.

2.3 Dokumentacionin e administruar nga ana e ZVRPP-së Tiranë.³

2.4 Kontratë shitblerje noteriale me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 19.05.2015.

2.5 Kontratë shitblerje, nr. *** rep., nr. *** kol., datë 19.05.2015.

2.6 Udhëzimin nr. 2, datë 06.08.2014, “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave për vitin 2014”.

b. Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me ligjin e zbatueshëm.

2.7 Në deklaratën “Vetting” të vitit 2017, subjekti i rivlerësimit deklaroi se ka në pronësi një apartament banimi me sipërfaqe 110.80 m², ndodhur në, Rr. “***”, Tiranë, blerë për shumën 42.280 euro dhe garazh, sip. totale 17.20 m², blerë për shumën 4.000 euro ose 560.000 lekë , Rr. “***”, Tiranë

2.8 **Për burimin e krijimit subjekti deklaroi** se ky apartament dhe garazh janë blerë nga të ardhura familjare dhe huaja marrë, më datë 02.09.2008, në shumën 30.000 euro. Me vlerë në lekë 5.919.200 lekë + 560.000 lekë.

2.9 Apartament, me sipërfaqe 110.80 m², e blerë në adresën, Rr. “***”, Tiranë, e deklaruar dhe referuar sipas kontratës shitje, datë 19.05.2015, **me çmim 42.280 euro**. Blerë sipas

³ Shkresa nr. *** prot., datë 16.02.2018, dërguar nga ZVRPP-ja Tiranë

kontratës noteriale me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 19.05.2015, në vlerën prej 42.280 eurosh, kursi i këmbimit 140 lekë/euro, (sipas deklaramit të subjektit) e lidhur ndërmjet palëve, F.Gj. shitëse dhe Agron Vavla blerës.

2.10 Me kontratë shitje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 19.05.2015, subjekti i rivlerësimit, ka blerë garazh me vlerë 4.000 euro, të konvertuar me 140 lekë/euro, **gjithsej 560.000 lekë**. Kjo shumë është likuiduar me depozitim *cash* të kryer, më datë 18.05.2015, në Bankën Kombëtare Tregtare nga z. Agron Vavla në llogarinë e noteres E.J., person fizik.

2.11 Në deklaramin vjetor të viti 2015, subjekti i rivlerësimit, deklaroi shpenzime të kryera në shumën prej rreth 1.584.000 lekësh, për mobilimin e apartamentit me sipërfaqe 110.80 m², në Rr. “***”, Tiranë, në vitin 2015.

20.12 Në lidhje me çmimin e blerjes së apartamentit sipas sipërfaqes dhe bazuar në Udhëzimin nr. 2, datë 06.08.2014, “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banësive për vitin 2014, çmimi i referencës të Entit Kombëtar të Banësive një vit më parë, viti 2014, në fuqi në kohën e blerjes së apartamentit, është **110.80 m², sip. e apartamentit X 785.88 euro m² = 87.075 euro gjithsej**.

Në lidhje me burimin e të ardhurave.

2.13 Në deklaramin “Vetting” të vitit 2017, subjekti ka deklaruar se ky apartament dhe garazh janë blerë nga të ardhura familjare dhe huaja marrë, në datë 02.09.2008, në shumën 30.000 euro. Me vlerë në lekë 5.919.200 lekë + 560.000 lekë.

2.14 Nga të ardhurat familjare është paguar shuma prej 16.280 eurosh, të cilat përbehen nga rrogat e subjektit dhe bashkëshortes dhe likuiditetet në bankë dhe *cash*.

2.15 Në lidhje me huan e marrë në vitin 2008, nga nipi i bashkëshortes në shumën 30.000 euro, rezultoi se në momentin e marrjes kjo hua është përdorur për të porositur një apartament, me sip. 127.5 m², në Qesarak, Tiranë, vlera 44.625 euro, me anë të kontratës së sipërmarrjes, nr. ***, datë 13.08.2008, me shoqërinë “****” sh.p.k. Kjo pagesë i është kryer firmës “****” sh.p.k., me anë të mandatarkëtimit nr. ***, datë 13.09.2008, për subjektin “****” sh.p.k., arkëtuar shuma 44.625 euro nga z. Agron Vavla si pagesë për likuidimin e vlerës së apartamentit.

2.16 Në vitin 2012, subjekti ka deklaruar në deklaramin vjetor të vitit 2012 revokimin e kontratës nr. ***, datë 13.08.2008, me kontratën nr. ***, datë 24.03.2012, duke marrë mbrapsht vlerën prej 44.625 eurosh + 2.000 euro penalitet, meqenëse nuk janë përmbushur kushtet e kontratës së sipërmarrjes në afat, për objektin apartament banimi në Qesarak, Tiranë.

2.17 Subjekti ka dërguar dokumentacion nga personi tjetër i lidhur, z. K.Sh., por që është në gjuhën italiane dhe nuk kuptohet sa janë të ardhurat e tij dhe nëse mjaftojnë për të justifikuar dhënien hua të kësaj shume.

Nga hetimi administrativ kryesisht, Komisioni konstatoi se:

2.18 Ka mospërputhje midis datës së pagesës së shumën 44.625 euro për apartamentin në Qesarakë, likuiduar para datës 13.08.2008, ndërkohë që huaja është marrë, më datë 02.09.2008, dhe depozita në “ProCredit Bank” është tërhequr më datë 10.9.2008. Mandatpagesa për likuidimin e vlerës 44.625 euro për subjektin “****” sh.p.k., mban datën 13.09.2008, me përshkrimin blerje apartamenti.

2.19 Se çmimi i blerjes së këtij apartamentit dhe garazhi është çmim preferencial krahasuar me çmimet për koston mesatare të shfrytëzimit nga Enti Kombëtar i Banësive për vitin 2014. Sipas kontratës së shitblerjes, çmimi është në vlerën 53.480 lekë/m², ndërsa sipas udhëzimit nr. 2, datë 06.08.2014, i Këshillit të Ministrave, çmimi është në vlerën 110.000 lekë/m². Pra,

çmimi për blerjen sipas kontratës për m² ka një diferencë 50 % të çmimit për m² sipas udhëzimit nr. 2 të Këshillit të Ministrave.

2.20 Subjekti i rivlerësimit nuk ka të ardhura familjare nga burime të ligjshme në shumën prej 16.560 eurosh ose 2.280.000 lekë, për të blerë apartamentin dhe garazhin. Sipas analizës financiare të vitit 2015, vit kur subjekti ka blerë apartamentin dhe garazhin ka mungesë të burimeve të ligjshme, në shumë prej -2.590.429lekësh.

2.21 Subjekti i rivlerësimit, ka mungesë të dokumentacionit justifikues ligjor nga personi tjetër i lidhur, huadhënësi K.Sh., në lidhje me burimin e krijimit të shumës prej 30.000 eurosh dhënë hua. Si dhe dokumentacioni i dërguar nga subjekti deri më tani është në gjuhën italiane, i padeshifrueshëm, pa ekstremitet e njohura nga shteti shqiptar dhe nuk është e qartë se si është transferuar kjo shumë nga Italia në Shqipëri nga z. K.Sh.

2.22 Komisioni, pasi shqyrtoi dhe analizoi shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit dhe deklaratimet e bëra në seancë dëgjimore arrin në përfundimin se:

2.23 Lidhur me çmimin e blerjes së apartamenti, subjekti i rivlerësimit nuk arriti të shpjegojë bindshëm diferencën prej 50 % më pak të blerjes së apartamentit, krahasuar me çmimin për m² sipas, udhëzimit nr. 2, datë 06.08.2014.

2.24 Subjekti i rivlerësimit, nuk shpjegoi bindshëm se si ishte e mundur që për prenotimin e një apartamenti me sipërfaqe 127 m², të pandërtuar, në vitin 2008, në Qesarakë, Tiranë, zonë periferike (*thujtje fshat - tha subjekti*) ai paguan shumën prej 44.625 eurosh, ndërkohë që 7 vjet më vonë, në vitin 2015 për blerjen e një apartamenti me sip. 110 m² + 17 m² garazh, të përfunduar, në një zonë preferenciale në Tiranë, paguan shumën prej 46.280 eurosh. Komisioni, krijoi bindjen se subjekti i rivlerësimit ka paraqitur në mënyrë të pasaktë pasurinë në pronësi duke mos provuar të kundërtën e rezultatit të Komisionit se çmimi i këtij apartamenti është shumë më lirë se vlera e tregut për këtë zonë.

2.25 Në lidhje me burimin e krijimit të këtij apartamenti dhe garazhi nga të ardhurat familjare, referuar analizës financiare, subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve të ligjshme shoqëruar me dokumentacion justifikues ligjor, në shumën -2.590.429 lekë, në vitin 2015, për të blerë shtëpinë dhe garazhin për kontributin prej 16.000 eurosh.

2.26 Në lidhje me burimin tjetër të përdorur, huadhënien e shumës prej 30.000 eurosh nga, z. K.Sh., subjekti i rivlerësimit, nuk provoi me dokumentacion justifikues ligjor se huadhënësi ka burime të ligjshme për të dhënë hua këtë shumë, si dhe mënyrën se si i ishin dhënë këto para subjektit apo dhe faktin se si kishin ardhur nga Italia në Shqipëri.

2.27 Më tej, Komisioni, me anë të sistemit *TIMS* provoi se, huadhënësi K.Sh., nuk kishte qenë në Shqipëri në momentin e firmosjes dhe dhënies së kësaj shume, më datë 02.09.2018, siç dhe pretendon subjekti. Subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë të kundërtën e rezultateve të hetimit në lidhje me prezencën dhe dhënien e lekëve.

2.28 Huadhënësi K.Sh. nuk provon me dokumentacion ligjor justifikues se ka të ardhura nga burime të ligjshme për të dhënë huan në shumën prej 30.000 eurosh në vitin 2008. Si konkluzion, subjekti i rivlerësimit, ka kryer deklaratim të rremë në lidhje me burimin e krijimit të këtij apartamenti, pasi ai nuk arriti të provojë se kishte të ardhura të ligjshme nga kursimet familjare, dhe nuk provoi se, z. K.Sh., kishte të ardhura të mjaftueshme për të dhënë këtë hua.

2.29 Sipas analizës financiare të vitit 2015, vit kur subjekti ka blerë apartamentin dhe garazhin rezulton se ka mungesë të burimeve të ligjshme, në shumë prej -2.590.429 lekësh.

2.30 Lidhur me prapsimin e subjekti të rivlerësimit se:

2.31 “Hetimi administrativ, punonjësi që ka kryer rivlerësimin e pasurisë, ka keq interpretuar udhëzimin nr. 2, datë 06.08.2014, pasi në referencë po të këtij udhëzimi, në tabelën nr. 3, jepen të dhënat e tregut të lirë të apartamenteve në qytetin e Tiranës, për vitin 2014. Hetimi administrativ, ka marrë për bazë vlerën 110.000 lekë/m², sipërfaqe shfrytëzimi për banesat e ndodhura në zonën ***, Tiranë. Banesa në pronësi të subjektit nuk ndodhet në zonën ***, por në zonën *** (*shih aktin e pronësisë të ZVRPP-së Tiranë, për këtë pasuri*).

Komisioni, arsyeton se pretendimi i subjekti nuk qëndron pasi pas hetimit të Komisionit nga përgjigja e ardhur nga ZVRPP-ja Tiranë me nr. *** prot., datë 16.02.2018, nuk citohet në asnjë vend që kjo pasuri është përfshirë në zonën ***. Çmimi i përlllogaritur nga Komisioni është sipas udhëzimit nr. 2, datë 06.08.2014, në tabelën nr. 3, “Të dhënat e tregut të lirë të apartamenteve në qytetin e Tiranës për vitin 2014“, zona *** ku bie pasuria e blerë nga subjekti ka çmim referencë 110.000 lekë për m². Kjo zonë përfshin të gjithë territorin nga shkolla e baletit deri tek rruga e hyrjes kryesore e ambasadës amerikane në Tiranë, pra me çmim 110.000 lekë për m², është zona ***, çmim i cili nuk ka ndryshuar as në vitin 2016 ku është i njëjti çmim reference.

Edhe nëse marrim për bazë zonën *** ashtu siç pretendon subjekti, sipas përlllogaritjeve del se: sipërfaqe banimi 110.80 m² blerë, më datë 19.05.2015, çmimi sipas udhëzimit të Entit Kombëtar të Banesave dhe pretendimit të subjektit, për vlerën prej 80.000 lekësh/ m². Kursi i këmbimit valutës, datë 19.05.2015, është 1 euro=139.97 lekë. Atëherë 110.80 m² x 80.000 lekë (sipas subjektit) = 8.864.000 lekë. Po ta kthejmë këtë shumë në euro monedhën e kontratës së blerjes del shuma prej 63.327 eurosh. Në këto kushte edhe po të marrim zonën *** të vendndodhjes së banesës së blerë siç pretendon subjekti vlera e banesës nga përlllogaritja del 63.327 euro. Kjo vlerë prej 63.327 eurosh përsëri është vlerë më e lartë sesa vlera prej 42.280 eurosh e kontratës së shitblerjes së apartamentit me sipërfaqe 110.80 m², të ndodhur në, Rr. “***”.

2.32 Subjekti i rivlerësimit gjatë seancës dëgjimore në lidhje me pyetjen se si e shpjegonte ai faktin se subjekti ka paguar për prenotimin e një apartamenti të pa përfunduar në Qesarakë, në rrëzë të Dajtit, shumën prej 44.000 eurosh, ndërkohë që pothuajse për një shumë të përafërt blen një apartament të përfunduar në Qytetin Studenti (zonë e preferuar ose “Bashi i vendit”) për një shumë prej 42.280 eurosh. Ndërkohë që subjekti i rivlerësimit iu përgjigj kësaj pyetje duke deklaruar se: “*po të shikohet me kujdes kontrata e sipërmarrjes, sipërfaqja e banimit në Qesarakë është një shifër, në kujtesën time, se tani nuk e kam kontratën por me një sip. 127 m². Ndërsa kontrata e shitjes në qytetin studentit është për një sip. 110 m². Kjo diferencë, po ta mbledhësh, po ta shumëzosh me metra katrorë, besoj që është e justifikueshme diferenca prej 2.000 eurosh.*”

Referuar për sa më sipër, Komisioni, arsyeton se pretendimi i paraqitur nga subjekti i rivlerësimit për sa i përket sipërfaqes nuk qëndron, pasi apartamenti në periferi të Tiranës, në Qesarak, është 127 m² dhe i pandërtuar, dhe ka kushtuar në vlerën 44.625 euro ndërkohë që apartamenti i blerë nga subjekti i rivlerësimit, në Tiranë, në Rr. “***” i cili ndodhet në një zonë të preferuar dhe m² të apartament plus garazhin janë në të njëjtë sipërfaqe 127 m² ka kushtuar në vlerën 46.280 euro.

Komisioni, çmon se çmimi i apartamentit të ndodhur në Rr. “****”, blerë në vitin 2015, i përfunduar, nuk mund të jetë afërsisht sa një apartament i papërfunduar në Qesarakë, Tiranë, zonë periferike, siç pretendon subjekti. Subjekti nuk arriti të shpjegojë bindshëm dhe të provojë se çmimi prej 44.280 eurosh që ka paguar për apartamentin, në Rr. “****”, të përfunduar në vitin 2015, nuk ishte i lirë apo preferencial.

2.33 Ka pasur të ardhura familjare dhe interesat bankare të realizuara në vitet 2002 - 2008 që kanë mbuluar shumë prej 14.280 eurosh, si pjesë për blerjen e apartamentit dhe garazhit nga të ardhurat familjare në vitin 2015. Për të vërtetuar këtë deklaram, subjekti solli një analizë financiare të kryer nga eksperti i tij.

Komisioni në lidhje me këtë prapsim, rishikoi analizën financiare duke marrë në konsideratë fitimin nga kursi i këmbimit për vitet 2012 - 2015 dhe balanca në minus ndryshoi nga shuma - 3.176.626 lekë në shumë -2.590.429 lekë. Pavarësisht këtij rishikimi, subjekti i rivlerësimit përsëri rezulton me mungesë të burimeve të ligjshme në shumën -2.590.429 lekë. Për më shumë referohu në tabelën nr. 1.

Tabela nr. 1. Analiza financiare për vitin 2015.

Nr.	Përshkrimi	Analiza e Komisionit sipas rezultateve të hetimit	Prapsimet e ekspertit të subjektit	Rishikimi i analizës nga Komisioni
A	Pasuritë	1,922,625	-1,328,647	1,467,359
1	Apartament banimi me sip. 110,8 m ² , Rr. “****”	5,919,200	5,846,478	5,919,200
2	Garazh sipas kont. noteriale nr. ****, me sip. 17.2 m ²	560,000	553,120	560,000
3	LIKUIDITETET	-4,556,575	-9,828,245	-7,111,841
4	Obligacione		2,100,000	2,100,000
	Të ardhurat	2,798,801	2,808,756	2,798,801
1	Nga paga	1,437,740	1,438,065	1,437,740
2	Paga e bashkëshortes	383,550	383,530	383,550
3	ISSH për bashkëshorten	47,950	57,600	47,950
4	Interesa bankare llog. kursimi në “Raiffeisen Bank”, z. Agron Vavla.	17,847	17,847	17,847
5	Paga e djalit periudha 01.03.2010 - 31.12.2010	341,685	341,685	341,685
6	Paga e vajzës	50,575	50,575	50,575
7	Dhuratë nga vajza në SHBA	519,454	519,454	519,454
C	Detyrimet	-412,950	-497,808	-412,950
	Shlyerja e kësteve të huas	-412,950		-412,950
D	Shpenzime	3,639,853	3,565,615	3,639,853
2	Interesa për këstet e huas	82,590		82,590
8	Për mobilimin e shtëpisë	1,584,324	1,584,324	1,584,324
9	Udhëtim jashtë shtetit në SHBA	1,019,454	1,019,454	1,019,454
14	Shpenzime jetike	953,484	961,837	822,552
	DIFERENCA	-3,176,626		-2,590,429

2.34 Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur si provë dy kontrata shitje të apartamenteve të ndryshme, të të njëjtit pallat ku janë dhe pasuritë objekt hetimi, ku veprimet në shitje janë kryer

nga e njëjta shitëse, znj. F.Gj., në vitin 2015 dhe veprimet noteriale janë kryer nga e njëjta notere, znj. E.B.J., në Tiranë, si më poshtë:

- i. kontrata e shitjes me kusht të pasurisë së paluajtshme me nr. ***, datë 05.12.2015, pasuria me nr. ***, me sipërfaqe totale 102 m² është shitur në shumën 5.500.000 lekë.
- ii. kontrata e shitjes së pasurisë së paluajtshme me nr. ***, datë 27.08.2015, pasuria me nr. ***, me sipërfaqe totale 102 m², është shitur në shumën prej 6.630.000 lekësh.

Në lidhje me sa më lart, Komisioni, arsyeton se këto prova merren në konsideratë me rezervë pasi ato nuk kanë kushte të njëjta në kontratë si dhe subjekti. Pagesa në këto kontrata është me këste dhe me transferim bankar nga një llogari në tjetrën, ndërsa subjekti e ka paguar shumën menjëherë si dhe e ka paguar nga arka e tij cash. Komisioni nuk i merr në konsideratë kontratat e dërguara për provë të re, për aq sa këto kontrata kanë kushte të ndryshme shitje.

2.35 Akti është dhënë në gjuhën italiane, pasi tregon vetëm faktin se ky shtetas ka qenë dhe është në gjendje të mirë financiare dhe ka siguruar të ardhura të ligjshme, si dhe formulari është tip, i miratuar nga autoriteti financiar italian. Këto akte, mund të merren vetëm nga personi që ka deklaruar të ardhurat vjetore ose nga përfaqësuesi i ndërmarrjes ku ka punuar personi, ose nga personi që ka kodin fiskal. Nuk është e nevojshme përkthimi edhe për faktin se në ekstremitetet vërtetohet emri i shtetasi K.Sh., të ardhurat e realizuara në vite dhe kodi fiskal, si dhe ndërmarrja ku ka punuar. Një ekspert i fushës financiare mund të interpretojë këto akte.

Në lidhje me sa më lart, Komisioni arsyeton se prapsimi i subjektit të rivlerësimit është i pabazuar në nenin 266 të Kodit të Procedurës Civile, “Shkresa në gjuhë të huaj”, i cili parashikon se: *“Kur shkresa është në gjuhë të huaj, ajo paraqitet bashkë me përkthimin e saj në gjuhën shqipe, të legalizuar nga ambasada apo konsullata përkatëse ose nga organ tjerë kompetent.”*

Referuar nenit 246 të Kodit të Procedurës Civile, “Fuqia Provuese e shkresave”, parashikohet se: *“Shkresat kanë fuqi provuese kur janë hartuar në formën e caktuar, kanë elementët e nevojshëm për vlerën e tyre...”*

2.36 Në lidhje me gjetjen e Komisionit se nuk është e qartë se si është transferuar kjo shumë nga Italia në Shqipëri, subjekti i rivlerësimit pretendon se huadhënësi e ka sjellë herë pas here këtë shumë, sa herë ka ardhur në Shqipëri.

Komisioni në lidhje me këtë pretendim argumenton se subjekti i rivlerësimit nuk provon me dokumentacion justifikues deklarata e tij në lidhje me këtë fakt.

2.37 Në lidhje me prapsimin e subjektit të rivlerësimit se: “Shtetasi K.Sh., në momentin e nënshkrimit të kontratës së huas para noter L.I., më datë 02.09.2008, ka qenë prezent dhe ka nënshkruar personalisht sipas vullnetit të lirë të tij. Kjo vërtetohet nga nënshkrimi origjinal në kontratë, para noterit. Për këtë arsye, për të vërtetuar nënshkrimin mund të kryhet akt ekspertimi”.

Komisioni, çmon se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë me dokumentacion ligjor provues se, z. K.Sh., ka qenë në Shqipëri në momentin e firmosjes së kontratës së huas. Më tej, Komisioni, vlerëson se është i rëndësishëm elementi kohë i kontratës, duke qenë se kjo hua është përdorur për pagimin e prenotimit të një apartamenti në gusht të vitit 2008. Ndërkohë që subjekti kërkon të provojë prezencën në momentin e firmosjes me origjinalitetin e firmës dhe mospërputhjet në sistemin TIMS.

2.38 Subjekti i rivlerësimit kërkoi të merret si provë thirrja në cilësinë e dëshmitarit të shtetasis K.Sh. dhe kryerja e akt ekspertimit të nënshkrimit të tij në këtë kontratë, për të provuar prezencën e tij në Shqipëri në momentin e firmosjes së kontratës.

Komisioni refuzoi kërkesën e subjektit të rivlerësimit për të thirrur në cilësinë e dëshmitarit, z. K.Sh., si dhe kryerjen e një akt ekspertimi për nënshkrimin e tij, për shkak se marrja e provës me dëshmitar në këtë rast është i panevojshëm dhe nuk lejohet pasi provimi i qenies prezent apo jo në momentin e nënshkrimit të kontratës së huas është veprim juridik që kërkon shkresë, ndërsa kryerja e vërtetimit të nënshkrimit ishte e panevojshme dhe bëhet me qëllim që të zvarrisë procesin. Neni 49 i ligjit nr. 84/2016 parashikon se: *“Kërkesa për marrjen e një prove refuzohet nga Komisioni, nëse nuk lejohet nga ligji ose në rastet kur:*

- a. marrja e provës duket se është e panevojshme;*
- b. fakti që kërkohet të provohet është i parëndësishëm për vendimmarrjen ose mund të rezultojë i provuar gjatë gjykimit;*
- c. mjete të provës është tërësisht i papërshtatshëm ose i paarritshëm;*
- d. bëhet me qëllim zvarritjen e gjykimit;*
- e. pretendohet të provohet një fakt në favor të subjektit të rivlerësimit, i cili edhe po të konsiderohet i vërtetë, nuk ndikon në marrjen e vendimit”.*

3. Në lidhje me automjetin, “Mercedes Benz”, marka X3.

a. Komisioni, për vërtetimin e faktit dhe burimit të të ardhurave, administroi:

- 3.1 Deklaratën “Vetting” të vitit 2017 dhe dokumentacionin bashkëlidhur, dorëzuar pranë ILDKPKI-së.
- 3.2 Deklaratën e interesave privatë, periodike vjetore e vitit 2012.
- 3.3 Dokumentacionin e administruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor.⁴
- 3.4 Analizën financiare të kryer nga ana e Komisionit.

b. Arsytimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me ligjin e zbatueshëm.

3.5 Në deklaratën “Vetting” të vitit 2017, subjekti i rivlerësimit deklaroi se ka në pronësi një automjet, “Mercedes Benz”, marka X3, blerë në Gjermani, më datë 26.11.2012, në shumën 10.000 euro, me kursin e këmbimit 140 lekë/euro, paguar dogana në shumën 280.000 lekë, me targë ***. Vlera totale e pagua 1.680.000 lekë.

3.6 Si burim krijimi për blerjen e këtij automjeti subjekti i rivlerësimit deklaroi të ardhurat familjare si dhe të ardhura nga shitja e automjetit me targë ***, sipas kontratës së shitblerjes, nr. ***, datë 18.12.2012, në shumën 3.000 euro, e kurs 140 lekë/euro.

3.7 Nga hetimi administrativ kryesisht u konstatua se subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur dokumentacion ligjor provues për të vërtetuar deklaratimet e tij në lidhje me çmimin e blerjes së këtij automjeti.

3.8 DPSHTRR-ja konfirmon vetëm vlerën e paguar për zhdoganimin e këtij automjeti, por nuk ka asnjë dokumentacion në lidhje me kontratën e shitblerjes së këtij automjeti.

3.9 Referuar analizës financiare për vitin 2012, pjesë e rezultateve të hetimit, ku ishte bërë blerja, subjekti i rivlerësimit rezultoi se ka mungesë të burimeve të ligjshme financiare në shumën - 629.923 lekë.

⁴ Shkresa nr. *** prot., datë 09.08.2017, dhe nr. *** prot., më datë 17.08.2017, konfirmon se, z. Agron Vavla, ka në pronësinë e tij automjetin me targa ***. B/lidhur dosja e automjetit me targa ***.

3.10 Komisioni, pasi shqyrtoi dhe analizoi shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit dhe deklaratimet e bëra në seancë dëgjimore arrin në përfundimin se:

3.11 Subjekti i rivlerësimit nuk provoi me dokumentacion ligjor se çmimi i blerjes së këtij automjeti ishte në vlerën 10.000 euro, por ai bazohet vetëm në çmimin e referencës.

3.12 Neni 32, pika 1, e ligjit nr. 84/2016, parashikon se: “*Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, së bashku me deklaratën e pasurisë, paraqesin të gjitha dokumentet që justifikojnë vërtetësinë e deklarimeve për ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive*”

3.13 Subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve të ligjshme financiare për të justifikuar blerjen e këtij automjeti në vitin 2012, një diferencë me minus në vlerën prej 141.495 lekë.

3.14 Lidhur me prapsimin e subjekti të rivlerësimit se në momentin e zhdoganimit të mjetit, autoriteti doganor nuk ka marrë në konsideratë faturën e origjinës së mallit (kontratën e shitblerje së mjetit apo faturën tatimore të ardhur nga Gjermania), por ka kryer vlerësimin e mjetit nëpërmjet procedurës së referencës doganore, për të cilën ka nxjerrë dokumentin administrative të vlerësimit (DAV).

Komisioni arsyeton se pavarësisht se vlerësimi i mjetit është bërë nëpërmjet procedurës së referencës doganore, subjekti i rivlerësimit duhet të kishte bashkëlidhur dhe në dosjen e zhdoganimit, faturën e blerjes ose kontratën e shitjes dhe mbi këtë bazë paguhet dhe tatimi mbi vlerën e shtuar, referuar ligji nr. 8449, datë 27.01.1999, “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” dhe aktet e dala në zbatim të tij.

3.15 Subjekti i rivlerësimit, paraqiti shkresën nr. *** prot., datë 11.12.2018, lëshuar nga Kryetari i Degës së Doganës Berat, bashkëlidhur dokumentacionin e vlerësimit të mjetit nëpërmjet referencës doganore, kopjet e njësuara me origjinalin të praktikës doganore IMP. ***, me R. ***, datë 13.01.2013, gjithsej 12 fletë. Shpjegimet e tij janë të njëjta me shpjegimet e dhëna, më datë 19.11.2018, për të provuar vlerën e blerjes së automjetit.

Komisioni arsyeton se marrja në konsideratë e kësaj shkrese nuk është e nevojshme për shkak se kjo nuk provon çmimin e blerjes së automjetit, por kjo shkresë paraqet vetëm praktikën e zhdoganimit të automjetit të blerë në Gjermani.

3.16 Nuk jemi dakord me analizën financiare të vitit 2012, pasi nuk përmban ekstremitetet, shpjegimet për të dhënat e pasqyruara si dhe nuk pasqyron me vërtetësi gjendjen e shifrave sipas deklaratës “Vetting”, apo deklaratave vjetore. Të ardhurat e krijuara janë të balancuar dhe nuk ka diferencë në vlerë.

Në lidhje me këtë prapsim, Komisioni, vlerëson se kjo analizë nga ana e subjektit ka konsideruar gjendje cash të likuiditeteve në euro të gjithë shumën prej 46.625 eurosh, ndërsa në analizën financiare të kryer nga ana e Komisionit janë marrë në konsideratë deklaratimet që subjekti ka bërë në deklaratën periodike vjetore të vitit 2012. Këto deklarime kanë marrë në konsideratë që gjendja cash e likuiditeteve në euro ka ndryshuar duke u shtuar me shumën prej 3.000 eurosh nga shitja e automjetit dhe duke u pakësuar me shumën prej 10.000 eurosh për blerjen e automjetit.

Komisioni, më tej ka rishikuar analizën financiare duke marrë në konsideratë efektin e ndryshimit të kursit të këmbimit euro/lekë të vitit 2008 me vitin 2012, efekt i cili është në shumën prej 737.986 lekësh. Edhe pas marrjes në konsideratë të kësaj shume, subjekti i rivlerësimit, ka një mungesë të burimeve të ligjshme financiare në shumë prej - 141.495 lekësh. Për më shumë referohu tabelës krahasuese për vitin 2012 si më poshtë:

Tabela nr.2. Analiza financiare për vitin 2012.

Nr.	Përshkrimi	Analiza e Komisionit sipas rezultateve të hetimit	Prapsimet e ekspertit të subjektit	Rishikimi i analizës nga Komisioni
A	Pasuritë	7,684,202	7,909,507	7,650,770
3	Automjet me targa ***	1,397,200	1,395,900	1,397,200
4	Automjet, tip " Citroen SAXO", traga ***, djali i subjektit, E.V.	69,860	69,975	69,860
5	LIKUIDITETET	6,217,142	6,443,632	6,183,710
	Të ardhurat	8,771,499	9,700,790	9,509,485
1	Nga paga	1,071,980	1,071,980	1,071,980
2	Paga e bashkëshortes	491,941	611,588	491,941
3	Interesa bankare, S.V.	28,499	103,541	28,499
4	Interesa bankare llogari kursimi në "Raiffeisen Bank", z. Agron Vavla	2,286		2,286
5	Interesa nga depozita në "Raiffeisen Bank"	72,756		72,756
6	Paga e djalit , periudha, 01.03.2010 – 31.12.2010	167,506	167,506	167,506
7	Mësimdhënie "****"	198,000	198,000	198,000
8	Paga e vajzës	542,912	621,021	542,912
9	Penalitet për zgjidhjen e kontratës së pronësisë	279,440	279,180	279,440
10	Revokim i kontratës për shtesë sip. Banimi 127.5 m ²	5,497,019	6,229,204	5,497,019
11	Shitja e automjetit "Mercedez Benz", me targa ***	419,160	418,770	419,160
12	Efekti nga ndryshimi i kursit të këmbimit	0		737,986
C	Detyrimet	-419,160	502,524	-419,160
1	Shlyerja e kësteve të huas	-419,160		-419,160
D	Shpenzime	1,378,900	1,288,759	1,378,900
1	Interesa për këstet e huas	83,832		83,832
3	Bilete udhëtimi për Gjermani	46,108	46,065	46,108
4	Për shkollën e lartë për djalin "****"	209,580	345,000	209,580
5	Për udhëtim jashtë vendit	13,972	13,972	13,972
6	Shpenzime jetike	944,568	883,722	944,568
	DIFERENCA	-629,923	0	- 141,495

4. Letra me vlerë në obligacione thesari pranë “Raiffeisen Bank”.

a. Komisioni, për vërtetimin e faktit dhe burimit të të ardhurave, administroi:

- 4.1 Deklaratën “Vetting” të vitit 2017 dhe dokumentacionin bashkëlidhur, dorëzuar pranë ILDKPKI-së.⁵
- 4.2 Deklaratën e interesave privatë, periodike vjetore e vitit 2004
- 4.3 Dokumentacionin e administruar nga “ProCredit Bank” dhe “Raiffeisen Bank”.⁶
- 4.4 Dokumentacionin e depozituar nga subjekti i rivlerësimit për të ardhurat.
- 4.5 Analizën financiare të përgatitur nga ana e Komisionit.

b. Arsytimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me ligjin e zbatueshëm.

4.6 Në deklaratën “Vetting” të vitit 2017, subjekti ka deklaruar se ka letra me vlerë në obligacione thesari pranë “Raiffeisen Bank”, më datë 06.07.2015, në shumën 2.100.000 lekë.

4.7 Si burim krijimi, subjekti deklaroi të ardhurat familjare.

4.8 Nga hetimi administrativ kryesisht, Komisioni ka konstatuar se për blerjen e këtyre obligacioneve subjekti i rivlerësimit ka transferuar nga depozita e kursimit në “ProCredit Bank” tek “Raiffeisen Bank”, më datë 26.06.2015, shumën prej 2.142.109 lekësh me përshkrim “*Transfertë kombëtare dalëse*” dhe ka vendosur Obligacione, shumën prej 2.100.000 lekësh.

4.9 Nga analizimi i depozitës në euro pranë “ProCredit Bank” dhe të llogarisë së pagës në lekë, konstatohet se në fund të vitit 2004, subjekti ka pasur gjendje në shumën 3.600 euro + 320.000 lekë dhe në “Raiffeisen Banka” ka pasur shumën 185.571 lekë, pra në total ka pasur shumën prej 846.345 lekësh gjendje në banka.

4.10 Nga analizimi i të ardhurave me dokumentacion ligjor justifikues rezulton se subjekti i rivlerësimit ka të ardhura nga puna e tij dhe e personit të lidhur/bashkëshortes, në shumën prej 1.133.676 lekësh.

4.11 Nga shuma e të ardhurave, në pikën 4.5 më lart, subjekti i rivlerësimit, ka shpenzuar: (i) për blerjen e automjetit, tip “Benz”, më targa ***, shumën prej 500.000 lekësh; (ii) shpenzime jetike sipas ISTAAT-it, në shumën 666.667 lekë; (iii) për udhëtim jashtë vendit shumë prej 57.033lekësh.

4.12 Subjekti ka shtuar gjendjen e likuiditeteve në bankë në shumën prej 961.835 lekësh.

4.13 Komisioni, pasi shqyrtoi dhe analizoi shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit dhe deklaratimet e bëra në seancë dëgjimore arrin në përfundimin se:

4.14 Subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të krijuar dy depozitat : (i) pranë “ProCredit Bank” në shumën 3.600 euro + 320.000 lekë dhe (ii) depozitën në shumë prej 185.571 lekësh pranë “Raiffeisen Bank”, depozita të cilat kanë shërbyer si burim fillestar për krijimin e shumës 2.100.000 lekë.

⁵ Vërtetim nr. ***, datë 11.01.2017, nga “Raiffeisen Bank”, ku vërtetohet se, z. Agron Vavla, ka obligacione, në vlerën 2.100.000 lekë.

Vërtetim nga “Raiffeisen Bank”, datë 14.06.2015, mbi shpalljen fitues të ankandit nr. ***.

“Raiffeisen Bank”, me shkresën nr. *** prot., datë 24.07.2017, konfirmon se, z. Agron Vavla, disponon bono thesari me gjendje, më datë 30.01.2017, në vlerën 2.100.000 lekë.

⁶ Shkresa nr. *** prot., datë 13.03.2018, nga “Raiffeisen Bank”.

Shkresa nr. *** prot., datë 13.03.2018.

4.15 Sipas analizës financiare për vitin 2004, subjekti i rivlerësimit ka mungesë të ardhurash nga burime të ligjshme në shumën prej -919.454 lekësh, siç përshkruhet në tabelën më poshtë:

Tabela nr. 3. Analiza financiare për vitin 2004

A	Pasuritë	1,346,346
1	Autoveturë, tip “Mercedez Benz”, targa ***	500,000
2	LIKUIDITETET	846,345
	Të ardhurat	1,133,676
1	Nga paga	862,440
2	Paga e bashkëshortes	271,236
D	Shpenzime	706,785
1	Shp. sipas TIMS	57,033
2	Shpenzime sipas ILDKPKI	649,752
	DIFERENCA (B-A+C-D)	-919,454

4.16 Në lidhje me prapsimet e subjektit të rivlerësimit se deri, më datë 31.12.2002, gjendja në shtëpi në cash është në shumën 600.000 lekë dhe gjendja në bankë në shumën 800 euro. Ky është momenti i fillimit të pasurisë - thotë subjekti - gjendje e cila është mbartur dhe në fund të vitit 2003.

Komisioni arsyeton se përderisa subjekti i rivlerësimit pretendon gjendjen cash të mbartur nga viti 2002, por që nuk e ka deklaruar në deklaratën e vitit 2003, ky deklarim i tij në pretendimet përfundimtare nuk mund të merret në konsideratë, pasi ka vetëm efekt deklarativ dhe nuk përbën provë.

4.17 Subjekti i rivlerësimit pretendon se ka të ardhura të ligjshme në vitin 2015 dhe 2004 për të blerë obligacionet në shumën prej 2.100.000 lekësh duke paraqitur në tabelë të ardhurat. Komisioni arsyeton se tabela e paraqitur nga subjekti nuk provon se ai ka pasur të ardhura të ligjshme shoqëruar me dokumentacion justifikues në vitin 2004, vit kur dhe janë krijuar 2 depozita që kanë shërbyer si burim për blerjen e obligacioneve. Në këto kushte, subjekti i rivlerësimit nuk provoi dot të kundërtën e rezultateve të hetimit administrativ të Komisionit në lidhje me këtë pikë.

4.18 Sipas aktit të ekspertimit për vitin 2004, gjendja është 0(zero), pra e balancuar. Komisioni rishikoi analizën financiare të vitit 2004 dhe duke zbritur shumën prej 115.490 lekësh nga likuiditeti, subjekti i rivlerësimit është me diferencë minus në vlerën -919.454 lekë.

Tabela nr.4. Analiza financiare për vitin 2004 pas prapsimeve.

Nr.	Përshkrimi	Analiza e Komisionit sipas rezultateve të hetimit	Prapsimet e ekspertit të subjektit	Rishikimi i analizës nga Komisioni
A	Pasuritë	1,461,835	700,000	1,346,346
1	Autoveturë, “ Benz”, targa ***	500,000	500,000	500,000
2	LIKUIDITETET	961,835	200,000	846,345
B	Të ardhurat	1,133,676	1,200,000	1,133,676
1	Nga paga	862,440	900,000	862,440
2	Paga e bashkëshortes	271,236	300,000	271,236

C	Shpenzime	706,785	500,000	706,785
1	Shpenzime sipas <i>TIMS</i>	57,033	0	57,033
2	Shpenzime jetike	649,752	500,000	649,752
	DIFERENCA	-1,034,944	0	-919,454

5. Të ardhurat dhe shpenzimet e personit të lidhur/djali i subjektit, E.V.

a. Komisioni, për vërtetimin e faktit dhe burimit të të ardhurave, administroi:

5.1 Deklaratën “Vetting” të vitit 2017 dhe dokumentacionin bashkëlidhur, dorëzuar pranë ILDKPKI-së.

5.2 Deklaratën e interesave privatë, periodike vjetore e vitit 2016.

5.3 Deklarimet e bëra nga subjekti i rivlerësimit me anë të postës elektronike.⁷

a. Arsytimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me ligjin e zbatueshëm.

5.4 Në deklaratën “Vetting” të vitit 2017, djali i subjektit të rivlerësimit, E.V., deklaron të ardhura nga puna në shumën prej 761.569 lekësh.

5.5 **Burimi i krijimit të këtyre të ardhurave** janë (i) nga paga, si punonjës i DHL-së në Tiranë, për periudhën tetor 2012 - janar 2013 dhe korrik - gusht 2011, në shumën 266.060 lekë (ii) të ardhura nga paga si punonjës pranë shoqërisë “****” sh.p.k., Tiranë, për periudhën 1 shtator - 30 nëntor 2014, në shumën 120.000 lekë (iii) të ardhura nga paga si punonjës pranë shoqërisë së sigurimeve “****” sh.a, Tiranë, për periudhën dhjetor 2014 - nëntor 2015, në shumën 375.509 lekë. Nga shtatori 2016 e në vazhdim është student, master në SHBA. Vlera totale 761.569 lekë

5.6 Në përgjigje të pyetësorit standard nga Komisioni subjekti deklaron se personi i lidhur/djali i subjektit jeton dhe studion në SHBA që nga gushti i vitit 2016.

5.7 **Nga hetimit administrativ kryesisht u konstatua se**, subjekti i rivlerësimit, nuk ka deklaruar në deklaratën “Vetting” të vitit 2017 shpenzimet për shkollimin dhe jetesën e personit të lidhur/djalit të subjektit në SHBA si dhe sponsorizimin e bërë nga, z. L.B., në vitin 2016.

5.8 Komisioni pyeti subjektin e rivlerësimit në lidhje me këtë konstatim, dhe subjekti me anë të postës elektronike deklaroi se, E.V., më datë 14.08.2016, ka udhëtuar drejt SHBA-së për studime dhe për shkollimin e tij, subjekti ka shpenzuar dhe paguar shumën prej 64.020,04 USD sipas kësteve të përshkruara më poshtë:

- i. Vjeshtë 2016 shuma prej 18.230,90 USD;
- ii. Pranverë 2017 shuma prej 23.241,14 USD;
- iii. Vjeshtë 2017 shuma prej 22.584,80 USD;

5.9 Më tej subjekti deklaroi se shpenzimet për jetesën e djalit në SHBA, janë në shumën 12.000 USD, të cilat ndahen 25 USD /dita X 30 ditë = 750 USD në muaj. Dhe për periudhën shtator 2016 - 31.12.2017 = 16 muaj X 750 USD = 12.000 USD. Shpenzime për jetesë dhe shkollim nga gushti i 2016 - 31.12.2017, subjekti ka deklaruar shumën prej 76.020,04 USD.

⁷ e-mail datë 1.02.2018.

e-mail datë 14.11.2018.

e-mail datë 16.11.2018.

e-mail datë 19.11.2018.

5.10 Si burim krijimi për këto të shpenzime të kryera për shkollim dhe jetesë, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar:

- i. Para *cash* të marra nga Shqipëria, më datë 14.08.2016, në shumë 8.000 USD, ku përfshihen 3.500 USD nga shitja e automjetit, më datë 05.08.2016 (në kontratën e shitjes së automjetit, datë 14.08.2016, vlera e shitjes së automjetit është 3.000 euro dhe jo 3.500 euro) dhe 4.500 USD nga familjarët e djalit dhe familjarët e prindërve.
- ii. Të ardhura nga punësimi *online* dhe punësime të tjera gjithsej në vlerën 13.314,47 USD, nga të cilat 11.814 USD të ardhura nga punësimi në periudhën janar - dhjetor 2017.
- iii. Pagesa nga sponsori, z. L.G.B., bashkëshorti i hallës, znj. L.B., në shumën 34.965 USD. Nga këto 19.965 USD për vitin 2016, 15.000 USD për vjeshtë të vitit 2017.

5.11 Pagesa nga shtetasi amerikan, z. Sh.Rr., në shumën 23.241,14 USD. Ky shtetas, deklaroi subjekti, ka marrë kredi në emër të tij dhe vlerën e kredisë e ka dërguar për financimin e shkollës së personit të lidhur/djalit të subjektit. Shlyerja do të fillojë pas përfundimit të shkollës.

5.12 Komisioni, pasi shqyrtoi dhe analizoi shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit dhe deklaratimet e bëra në seancë dëgjimore arrin në përfundimin se:

5.13 Subjekti rivlerësimit ka fshehur në deklaratë "Vetting" sponsorizimin e bërë nga, z. L.B., në shumën 18.230.90 USD në vitin 2016, duke mos e deklaruar tek detyrimet.

Sipas nenit D të Aneksit të Kushtetutës parashikohet se: *"Subjektet e rivlerësimit i nënshtrohen deklaratimit dhe kontrollit të pasurive të tyre, me qëllim që të identifikohen ata që kanë në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikohen ligjërisht, ose ata që nuk i kanë deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tyre dhe të personave të lidhur."*

Nëse subjekti i rivlerësimit përpiqet të fshehtë ose të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose në përdorim të tij, zbatohet parimi i prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit dhe subjekti ka detyrimin të provojë të kundërtën".

5.14 Subjekti i rivlerësimit ka fshehur në deklaratën e interesave privatë, periodike vjetore të vitit 2016, huan/sponsorizimin e marrë nga shtetasi L.B., me të cilën ka kryer pagesën në vjeshtë 2016 për shkollimin e personit të lidhur/djalit të subjektit në shumën 18.230,90 USD, në SHBA si dhe shpenzimet për akomodim dhe jetesë gjatë vitit 2016.

5.15 Subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaratim të rremë dhe ka mungesë të burimeve të ligjshme financiare gjatë vitit 2016 për shkollimin dhe akomodimin e personit të lidhur/djalit të tij.

5.16 Personi tjetër i lidhur/z. L.B. në cilësinë e sponsorizuesit nuk justifikoi ligjshmërinë e burimit të krijimit të të ardhurave.

Në lidhje me burimin e krijimit.

5.17 Komisioni konstaton se subjekti i rivlerësimit nuk ka bashkëlidhur dokumentacion justifikues ligjor për dhurimin e shumës prej 4.500 USD nga ana e prindërve të tij dhe familjarëve të prindërve të personit të lidhur/djalit sipas ligjit.

5.18 Subjekti i rivlerësimit nuk ka bashkëlidhur dokumentacion justifikues ligjor për të ardhurat e deklaruar nga punësimi në SHBA, në shumën 13.314 USD (p.sh kontratë pune, pagimin e tatimeve për të ardhurat etj.

Neni 32, pika 1, e ligjit nr. 84/2016, parashikon se: *"Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, së bashku me deklaratën e pasurisë, paraqesin të gjitha dokumentet që justifikojnë vërtetësinë e deklaratimeve për ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive."*

5.19 Subjekti i rivlerësimit nuk ka bashkëlidhur dokumentacion justifikues ligjor për aftësinë financiare të, z. L.B., në lidhje me sponsorizimin e bërë nga ana e tij në shumën 34.965 USD në total për shkollimin e personit të lidhur/djalit të subjektit të rivlerësimit.

5.20 Subjekti i rivlerësimit nuk ka bashkëlidhur dokumentacion justifikues për burimin e ligjshëm e të të ardhurave të, z. Sh.Rr., për shumën e sponsorizuar për shkollën e personit të lidhur/djalit të subjektit në vlerën 23.241,14 USD.

Neni 32, pika 4, e ligjit nr. 84/2016, parashikon se: *“Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, ose persona të tjerë të lidhur, të deklaruar në cilësinë e dhuruesit, huadhënësit ose huamarrësit, nëse konfirmojnë këto marrëdhënie, kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive.”*

5.21 Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur dokumentacion provues nga SHBA, por ky dokumentacion është i papërkthyer në gjuhën shqipe, i panoterizuar, i pakonfirmuar nga ambasada apo konsullata përkatëse .

Neni 266 i Kodit të Procedurës Civile, parashikon se: *“Shkresa në gjuhë të huaj”, parashikon se: “Kur shkresa është në gjuhë të huaj, ajo paraqitet bashkë me përkthimin e saj në gjuhën shqipe, të legalizuar nga ambasada apo konsullata përkatëse ose nga organ tjetër kompetent.”* Më tej, referuar nenit 246 të Kodit të Procedurës Civile, “Fuqia Provuese e shkresave”, parashikohet se: *“Shkresat kanë fuqi provuese kur janë hartuar në formën e caktuar, kanë elementët e nevojshëm për vlerën e tyre...”*

5.22 **Në lidhje me prapsimet e subjektit të rivlerësimit se:**

5.23 Për periudhën nga data 26.01.2017 dhe në vazhdim, deklarimi i pasurisë, angazhimet dhe veprimtaritë private dhe/ose publike, dhe të ardhurat e krijuara prej tyre, detyrimet financiare, nuk duhet të jenë objekt i hetimit në lidhje me kriterin e vlerësimit të pasurisë, edhe për personin e lidhur.

Lidhur për sa më lart, Komisioni, argumenton se procesi i hetimit në lidhje me kriterin e pasurisë nuk ka afat të përcaktuar kohor si para deklaratës “Vetting” ashtu dhe pas dorëzimit të saj, për aq sa mund ti shërbejnë hetimit të fakteve dhe rrethanave në lidhje me procesin e rivlerësimit të subjektit, referuar kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016.

5.24 Për sa i përket akomodimit, shpenzimet janë paguar nga familja e vajzës, me bashkëshort amerikan. Për sa i përket vlerës së qirasë dhe mënyrës së pagesës janë veprime që i përkasin shtetasve amerikane.

Në lidhje me sa më lart, Komisioni argumenton se pavarësisht se çfarë shtetësie ka dhuruesi apo mbështetësi, sipas nenit 32, pika 4, e ligjit nr. 84/2016, ai ka detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të të ardhurave.

Neni 32, pika 4, e ligjit nr. 84/2016, parashikon se: *“Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, ose persona të tjerë të lidhur, të deklaruar në cilësinë e dhuruesit, huadhënësit ose huamarrësit, nëse konfirmojnë këto marrëdhënie, kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive.”*

5.25 Në lidhje me dokumentacioni ligjor justifikues i sponsorit, z. L.G.B., për shumën 34.965 USD, të sponsorizuar për shkollimin e personit të lidhur, aktualisht ky shtetas ndodhet në Amerikë, si emigrant i ligjshëm. Unë nuk mund të marrë informacion nga “BKT-ja” për këtë llogari, pasi konsiderohen si të dhëna konfidenciale. Megjithatë, një nga mënyrat e krijimit

të burimit të të ardhurave mund të provohet dhe me qenien e bashkëshorteve L. dhe L.B. në marrëdhënie pune. Për këtë fakt po ju paraqes vërtetimet me nr. *** prot., datë 11.12.2018. dhe nr. *** prot., datë 11.12.2018, lëshuar nga Drejtori i Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Berat, ku pasqyrohen vjetërsia në punë për shtetasit L. dhe L.B.

Komisioni, argumenton se pavarësisht shkakut të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, ky është një detyrim ligjor i parashikuar në nenin 32, pika 4, e ligjit nr. 84/2016.

Në lidhje me vërtetimet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit për vjetërsinë në punë të shtetasit L. dhe L.B., lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Berat, Komisioni, arrin në përfundimin se sponsorizuesi, z. L.B., nuk ka mjaftueshëm të ardhura nga burime të ligjshme për të sponsorizuar shumën prej 34.965 USD, nga e cila shuma prej 19.965 USD është sponsorizuar gjatë vitit 2016.

Neni 32, pika 4, e ligjit nr. 84/2016 parashikon se: *“Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, ose persona të tjerë të lidhur, të deklaruar në cilësinë e dhuruesit, huadhënësit ose huamarrësit, nëse konfirmojnë këto marrëdhënie, kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive. ”*

5.26 Më tej subjekti prapson se për sa i përket burimit të krijimit të pagimit të shumën prej 23.241,14 USD dhe mënyrës së pagesës janë veprime që i përkasin shtetasit amerikan.

Edhe në lidhje me këtë prapsim, sikurse në pikën 5.24 , Komisioni, argumenton se pavarësisht se çfarë shtetësie ka dhuruesi apo mbështetësi, sipas nenit 32, pika 4, e ligjit nr. 84/2016, ai ka detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të të ardhurave.

Neni 32, pika 4, e ligjit nr. 84/2016, parashikon se: *“Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, ose persona të tjerë të lidhur, të deklaruar në cilësinë e dhuruesit, huadhënësit ose huamarrësit, nëse konfirmojnë këto marrëdhënie, kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive. ”*

6. Analiza financiare e viteve 2003 - 2016, të subjektit të rivlerësimit, bazuar në të dhënat e INSTAT-it dhe anketën familjare të viti 2006 po nga INSTAT.

6.1 Komisioni, pasi shqyrtoi dhe analizoi shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit dhe deklaratimet e bëra në seance dëgjimore arrin në përfundimin se:

6.2 Subjekti i rivlerësimit ka mungesë të të ardhurave nga burime të ligjshme në analizë të viteve 2003 - 2016 të marra së bashku, në shumën - 5.708.665 lekë, siç paraqitet në tabelën më poshtë:

Tabela nr. 4. Analiza financiare përfundimtare.

Viti	Të ardhura	Pasuritë	Detyrime (Principal + Interesa)	Shpenzime të tjera	Shp. jetike	Diferenca
2003	891,964	300,000			649,752	-57,788
2004	1,133,676	1,346,345		57,033	649,752	-919,454

2005	1,314,391	726,211			42,889	649,752	-104,461
2006	1,195,938	781,758			16,081	649,752	-251,653
2007	1,287,432	321,282			423,185	649,752	-106,787
2008	1,790,768	5,161,743	3,695,475		431,139	637,368	-744,007
2009	1,799,862	-8,232	-411,510	82,302	795,586	637,368	-118,672
2010	1,632,673	108,955	-416,430	83,286	832,860	718,248	-527,106
2011	1,767,527	-31,786	-414,900	82,980	352,665	944,568	4,200
2012	3,593,306	1,653,751	-419,160	83,832	350,500	944,568	141,495
2013	2,840,393	-219,279	-420,630	84,126	825,092	944,568	785,256
2014	3,240,036	657,498	-420,330	84,066	116,291	944,568	1,017,283
2015	2,798,801	1,467,359	-412,950	82,590	2,603,779	822,552	-2,590,429
2016	1,594,514	-1,603,913	-405,810	81,162	4,226,545	721,452	-2,236,543
Totali	26,881,281	10,661,692	373,755	664,344	11,073,646	10,564,020	-5,708,665

6.3 Në lidhje me prapsimet, subjekti i rivlerësimit, më datë 14.12.2018, ka paraqitur një akt ekspertim kontabël në lidhje me analizën ekonomiko - financiare të kryer nga Komisioni, nga ku rezulton se gjendja nga data 31.12.2002 deri në datën 31.12.2016, kryer në datën 13.12.2016 nga eksperti z. B.Ç., person fizik, kontabilist i miratuar me licence nr. ***, datë 26.02.2005, figuron me balancë 0 (zero).

Komisioni argumenton sa më poshtë:

1. Mbi llogaritjen e shpenzimeve jetike për periudhën 2003 - 2016.

Për shpenzimet jetike për vitet 2003, 2004 dhe 2005, nuk ka informacion nga INSTAT dhe janë marrë të barabarta me shpenzimet e llogaritura nga INSTAT në vitin 2006 në rrethin Berat deri në vitin 2010 që subjekti ka jetuar në Berat. Në vitin 2011 - 2016 janë marrë të dhënat nga Anketa e Buxhetit Familjes të INSTAT-it për familje sipas numrit të pjesëtarëve të familjes. Në llogaritjen e shpenzimeve jetike për periudhën 2006 - 2010 llogaritjet janë bërë në bazë të anketës së buxhetit të familjes për konsum sipas qarqeve (në Berat) dhe për periudhën 2011 deri në vitin 2016 janë marrë në konsideratë shpenzimet mujore për konsum sipas madhësisë së familjes.

2. Gjendja e likuiditeteve është e krijuar nga viti 2002 me të ardhurat e krijuara ndër vite.

Subjekti gjatë seancës dëgjimore pretendoi se, më datë 31.12. 2002, ka pasur gjendje *cash* likuiditetet në vlerën prej 600.000 lekësh.

Komisioni, çmon se përderisa kjo gjendje cash nuk është deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën periodike vjetore të vitit 2003 as si gjendje në fillim të vitit 2003 dhe as gjendje më datë 31.12.2003, kjo nuk merret në konsideratë.

3. Mbi llogaritjen e të ardhurave neto

Të ardhurat neto të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit në deklaratat periodike vjetore nuk janë të barabarta me të ardhurat neto sipas dokumentacionit të marrë nga institucionet përkatëse me vërtetim mbi të ardhurat neto të subjektit të rivlerësimit dhe të personave të lidhur si më poshtë vijon:

- i. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat, me shkresat nr. *** prot., dhe nr. *** prot., datë 16.01.2017.
- ii. Nga “***”, me shkresën nr. *** prot., datë 24.01.2017.
- iii. “***”, me shkresën me nr. *** prot., datë 09.01.2017, dhe nr. *** prot., datë 04.01.2017, për pagën neto të znj. F.V., si dhe shkresën nr. *** prot., datë 20.05.2014, “Mbi ndërprerjen e marrëdhënieve të punës në shoqërinë ‘***’ sh.a”.
- iv. Shoqëria “***” sh.p.k., nr. i kontratës së punës dhe pagesat për periudhën shtator 2015 dhe 2016.
- v. Nga Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, shkresa me nr. *** prot., datë 09.014.2015.
- vi. Nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm Shëndetësor, shkresa me nr. ***, datë 28.12.2016, për të ardhurat neto të vajzës së subjektit, S.V.
- vii. Nga DHL, vërtetim për të ardhurat neto të djalit të subjektit, E.V.
- viii. “***”, vërtetim datë 11.01.2015, për të ardhurat neto të djalit të subjektit, E.V.;
- ix. Vërtetim nga shoqëria e sigurimeve “***”, me shkresën me nr. *** prot., datë 28.12.2016;

4. Mbi gjendjen e likuiditeteve cash dhe në bankë

Në analizën financiare ekonomike vit pas viti në akt ekspertimin e kryer nga eksperti i subjektit të rivlerësimit janë llogaritur gjendje cash në banesë (në arkë) çdo vit, gjendje për të cilat pretendoi dhe subjekti i rivlerësimit në seancën dëgjimore.

Ndërkohë që nga verifikimi i deklaratave periodike vjetore subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar ndër vite gjendje cash të likuiditeteve (lekë), këto gjendje janë vetëm të llogaritura nga eksperti, ku çdo balancë pozitive që i rezulton në fund të vitit e deklaroi (kursime) gjendje cash për të nxjerrë balancën zero në fund të çdo viti dhe për ta pasqyruar si gjendje në fillim të vitit pasardhës. Subjekti i rivlerësimit e ka pasur detyrim ligjor që në deklaratat periodike vjetore të deklaroj kursimet, gjë të cilën nuk e ka bërë. Në periudhën 2008 deri në vitin 2013 ka deklaruar gjendje cash të djalit të subjektit, E.V., të cilat janë marrë në konsideratë.

Gjithashtu ka deklaruar në fund të vitit 2012 gjendje cash të fondeve në euro të rimarra nga shoqëria e ndërtimit për anulim të kontratës, në shumën prej 46.625 eurosh, duke shtuar shumën që ka shitur automjetin dhe pakësuar vlerën e automjetit të blerë në vlerën 10.000 euro. Nga viti 2012 deri në vitin 2015 subjekti i rivlerësimit ka deklaruar shtesa dhe pakësim të gjendjes cash në euro të cilat janë përlllogaritur në analizën financiare. Ndërsa nga eksperti në akt ekspertim janë marrë në konsideratë vetëm shtesat dhe jo pakësimet e gjendjes cash në euro të deklaruara në deklaratat periodike vjetore për shtesa dhe pakësime të kësaj, duke përdorur një gjendje cash në euro në 31 dhjetor 2014 më të madhe se gjendja reale.

VI. SI KONKLuzion PËR KRITERIN E PASURISË

Në përfundim të procesit të rivlerësimit për vlerërimin e pasurisë, referuar nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 33 të ligjit nr. 84/206, për subjektin e rivlerësimit, z. Agron Vavla, arrin në konkluzionin se:

- 1. Në lidhje me apartamentin e banimit, me sipërfaqe totale 57.1 m², ndodhur në, lagja “***”, Berat.**

- i. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në mënyrë të pasaktë dhe jo në përputhje me ligjin çmimin e këtij apartamenti.
- 2. Në lidhje me apartamentin e banimit, me sipërfaqe 110.80 m² dhe garazhin me sipërfaqe 17 m², ndodhur në, Rr. “***”, Tiranë.**
 - i. Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur në mënyrë të pasaktë çmimin e këtij apartamenti në pronësi dhe ka fshehur çmimin real.
 - ii. Subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar blerjen e këtij apartamenti dhe garazhi në shumë prej -2.590.429 lekësh;
 - iii. Subjekti i rivlerësimit, ka kryer deklaram të rremë në lidhje me burimin e krijimit të këtij apartamenti, pasi ai nuk arriti të provojë se kishte të ardhura të ligjshme nga kursimet familjare;
 - iv. Subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të rremë dhe ka mungesë dokumentacioni ligjor provues në lidhje me të ardhurat e z. K.Sh., për të provuar mundësinë financiare nga burime të ligjshme të tij, për të dhënë këtë hua.
 - v. Subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të rremë dhe ka mungesë burimi të ligjshëm financiar, në deklaratën e pasurisë, vetting, për shumën 1.580.000 lekë, për apartamentin me sip. 110.8 m², në Rr. “***”, në Tiranë, në vitin 2015.
- 3. Në lidhje me blerjen e automjetit, “Mercedes Benz”, marka X3.**
 - i. Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur në mënyrë të pasaktë çmimin e blerjes së këtij automjeti pasi nuk provoi me dokumentacion ligjor se çmimi i blerjes së këtij automjeti ishte në vlerën 10.000 euro.
 - ii. Subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve të ligjshme financiare për të justifikuar blerjen e këtij automjeti në vitin 2012, një diferencë me minus në vlerën prej 141.495 lekësh.
- 4. Në lidhje me letrat me vlerë në obligacione thesari pranë “Raiffeisen Bank”.**
 - i. Subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të rremë dhe ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar dy depozitat e krijuara : (1) pranë “ProCredit Bank” në shumën 3.600 euro + 320.000 lekë dhe (2) pranë “Raiffeisen Bank” në shumë prej 185.571 lekësh, depozita të cilat kanë shërbyer si burim fillestar për krijimin e shumës 2.100.000 lekë.
- 5. Në lidhje me të ardhurat dhe shpenzimet e personit të lidhur/djali i subjektit, E.V.**
 - i. Subjekti i rivlerësimit ka fshehur në deklaratë “Vetting” për vitin 2017, detyrimin e personit të lidhur/djalit të tij ndaj shtetasit L.B., në shumën 18.230.90 USD, transferuar në vitin 2016;
 - ii. Subjekti i rivlerësimit nuk provoi se sponsorizuesi L.B. kishte mundësi financiare nga burime të ligjshme për të dhënë huan në vitin 2016 dhe më tej në vitin 2017.
 - iii. Subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të rremë dhe ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për shkollimin dhe akomodimin e personit të lidhur/ djalit të tij në SHBA
- 6. Në lidhje me analizën financiare të viteve 2003 - 2016, të subjektit ë rivlerësimit, bazuar në të dhënat e INSTAT-it dhe anketën familjare të viti 2006 po nga INSTAT.**
 - i. Subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të rremë dhe ka mungesë të mjeteve financiare nga burime të ligjshme nga viti 2003 deri në vitin 2016, në shumën - 5.708.665 lekë, për të justifikuar deklaramet e bëra ndër vite.

Në këto kushte, Komisioni, bazuar në provat që disponon për vlerësimin e pasurisë, vlerësimin e çështjes në tërësi si dhe bindjen e brendshme vendosi që, subjektit të rivlerësimit, z. Agron Vavla, gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, t'i jepet masa disiplinore e shkarkimit nga detyra.

PËR KËTO ARSYE,

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe neni Ç, D, dhe Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë të ndryshuar si dhe të nenit 61 pika 3 të ligjit nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë",

V E N D O S I:

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Agron Vavla, gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat.
2. Vendimi i arsyetuar me shkrim u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, 30 ditë pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelimit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, më datë 21.12.2018.

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Firdes SHULI
Kryesues

Roland ILIA
Anëtar

Etleda ÇIFTJA
Relatore

Olsida GOXHAI
Sekretare gjyqësore